

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË STATUTIN E SHOQËRISË
“OPERATORI I SHËRBIMEVE TË INTEGRUARA TË STERILIZIMIT” SH.A
(OSHIS sh.a)

Në mbështetje të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 135, kreu I “Asambleja e Përgjithshme” të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, si dhe të Vendimit Nr. 629, datë 30.7.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 845, datë 30.12.2025, “Për krijimin e shoqërisë “Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit” sh.a. (OSHIS sh.a.) për ofrimin e shërbimeve të integruara të procesit të sterilizimit”, në Statutin e shoqërisë “Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit” sh.a. bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në të gjithë tekstin e Statutit, emërtimi i shoqërisë “Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit” sh.a. dhe emërtimi i saj i shkurtuar “OSHIS” sh.a. zëvendësohen, përkatësisht, me emërtimin “Operatori i Shërbimeve të Integruara Shëndetësore” sh.a. dhe emërtimin e shkurtuar “OSHISH sh.a.

I. Kreu I “Emërtimi i shoqërisë, objekti dhe mënyra e financimit”

Neni 1 “Forma e organizimit”

- **Pika 2, riformulohet me përmbajtje:** “Emri i shoqërisë është “Operatori i Shërbimeve të Integruara Shëndetësore” sh.a., ndërsa emërtimi i saj i shkurtuar është “OSHISH sh.a.”;
- **Pika 4, riformulohet me përmbajtje:** “Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet nga ky Statut, nga legjislacioni në fuqi dhe nga aktet e brendshme të miratuara nga organet kompetente të saj, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, transparencës, efikasitetit, llogaridhënies dhe qeverisjes së mirë korporative”.

Neni 2 “Selia e shoqërisë, stema dhe vula.”

- **Pika 1, ndryshon si vijon** “Selia qendrore e shoqërisë “Operatori i Shërbimeve të Integruara Shëndetësore” sh.a. (OSHISH sh.a.) ndodhet në adresën: Zona Kadastrale nr. 1751, nr. pasurie 55/17, Rruga Gjokaj, Bashkia Vorë, 1001, Tiranë”.
- **Pas pikës 3 shtohet pika 4 me përmbajtje:** “Forma, përmbajtja, mënyra e përdorimit dhe administrimit të stemës, logos dhe vulës së shoqërisë përcaktohen me aktet e brendshme të Shoqërisë, të miratuara nga organet kompetente të saj, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në këtë Statut”.

Neni 4 "Objekti i veprimtarisë"

- ***Në pikën 1, pas shkronjës "k" shtohen shkronjat "l", "m"; "n"; "o"; dhe "p", me përmbajtje:***

"l) ofrimin e shërbimeve të Programit Kombëtar të Kontrollit Mjekësor Bazë, si dhe organizimin e administrimit operacional të rrjetit të laboratorëve, të pikave të ofrimit të shërbimit, të proceseve logjistike, të sistemeve informatike, të pajisjeve dhe aseteve të nevojshme për realizimin e programit;

m) administrimin e rrjetit të laboratorëve dhe të pikave të ofrimit të shërbimit, si dhe koordinimin e proceseve logjistike dhe informatike, që lidhen me realizimin e Programit Kombëtar të Kontrollit Mjekësor Bazë;

n) kryerjen e çdo veprimtarie tjetër të nevojshme për zbatimin e Programit Kombëtar të Kontrollit Mjekësor Bazë, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

o) marrjen e masave të nevojshme organizative, teknike, logjistike dhe kontraktore për sigurimin e vazhdimësisë së pandërprerë të shërbimit të hemodializës, në përputhje me protokollet mjekësore të miratuara dhe legjislacionin në fuqi në 5 (pesë) qendrat pranë spitaleve Shkodër, Lezhë, Vlorë, Elbasan dhe Korçë, përfshirë zhvillimin e procedurave të prokurimit, lidhjen, administrimin e monitorimit e zbatimit të kontratave për mirëmbajtjen parandaluese dhe korrigjuese të pajisjeve mjekësore, si dhe për furnizimin me materiale të konsumit, mallra, pajisje, produkte dhe shërbime të tjera të nevojshme për funksionimin e këtij shërbimi, sigurimin e funksionimit normal të aparaturave dhe të pajisjeve mjekësore;

p) administrimin, menaxhimin e mirëmbajtjen e aseteve, të pajisjeve mjekësore, të sistemeve informatike dhe elementeve të tjera pasurore, që përdoren për ofrimin e shërbimeve në fushat e veprimtarisë së shoqërisë".

- Në fund të fjalisë së pikës 2, shtohet fjaltë "... si dhe institucioneve të kujdesit shëndetësor parësor dhe strukturave të tjera publike shëndetësore, sipas organizimit të Programit Kombëtar të Kontrollit Mjekësor Bazë".

Neni 5 "Mënyra e financimit"

- Në fund të pikës 1, shtohet fjaltë me përmbajtje: "Për ofrimin e shërbimeve shëndetësore të Programit Kombëtar të Kontrollit Mjekësor Bazë, si dhe ofrimin e shërbimit të hemodializës, OSHISH sh.a., si dhënë shërbimi i licencuar, financohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor".

- Në pikën dy shtohet një fjaltë me këtë përmbajtje: Tarifa për seancë e shërbimit të hemodializës është e përcaktuar me Vendimin Nr. 308, datë 21.5.2014, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në shërbimin spitalor" të ndryshuar".

Neni 9 “Transferimi i asetëve dhe të drejtave”, riformulohet si vijon:

- **Pika 1**, “Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale i kalon, pa pagesë, shoqërisë aksionare asetet, pajisjet, sistemet informatike, të drejtat dhe çdo element tjetër pasuror, që i kalojnë shtetit pas përfundimit të kontratës të partneritetit publik privat/koncesionit me Nr. 1440/40, datë 10.12.2015, “Për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale”, të ndryshuar, Nr. 3082/20, datë 7.1.2015, “Për paketën e shërbimeve të kontrollit mjekësor bazë për grup-moshat 40–65 vjeç”, të ndryshuar, si edhe Nr. 1503/44, datë 10.2.2016, “Për shërbimin e hemodializës”, në përputhje me parashikimet kontraktore dhe legjislacionin në fuqi”.

3. Në kreun III bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Neni 14 “Asambleja e Përgjithshme”

- **Pika 3 riformulohet si vijon:** “Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve të Asamblesë pa vonesë dhe, në çdo rast, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e miratimit të tyre. Regjistrimi kryhet nga Administratori, i cili përgjigjet për administrimin dhe ruajtjen e regjistrit në përputhje me legjislacionin në fuqi”.

Neni 17 “Këshilli Mbikëqyrës”

- Pika 1 riformulohet si vijon: “Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga pesë anëtarë, ku një prej tyre caktohet nga ministria përgjegjëse për financat. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë.

- Pika 3 riformulohet si vijon: “Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, parimet e transparencës financiare dhe politikat e shpërblimit të organeve drejtuese të shoqërisë”.

Neni 21 “Komiteti i Riskut dhe Auditit”, riformulohet si vijon:

“Neni 21

Komiteti i Auditimit dhe Menaxhimit të Riskut

1) Komiteti i Auditimit dhe Menaxhimit të Riskut është organ këshillimor i Këshillit Mbikëqyrës, i krijuar për të mbështetur ushtrimin e funksioneve të mbikëqyrjes, kontrollit të brendshëm, auditimit, përputhshmërisë dhe menaxhimit të riskut në Shoqëri.

- 2) Komiteti përbëhet nga jo më pak se tre (3) anëtarë. Anëtarët e Komitetit emërohen dhe shkarkohen nga Këshilli Mbikëqyrës. Kryetari i Komitetit zgjidhet nga Këshilli Mbikëqyrës ose nga vetë anëtarët e Komitetit, sipas vendimit të Këshillit Mbikëqyrës.
- 3) Në përbërje të Komitetit mund të emërohen edhe ekspertë të jashtëm, të pavarur nga Shoqëria, të cilët zotërojnë kualifikime dhe përvojë profesionale në fushat e auditimit, financës, kontabilitetit, sigurimeve, menaxhimit të riskut, kontrollit të brendshëm ose qeverisjes korporative. Numri i anëtarëve të jashtëm, të drejtat dhe detyrimet e tyre përcaktohen në vendimin e emërimit dhe në rregulloren e funksionimit të Komitetit.
- 4) Shumica e anëtarëve të Komitetit duhet të kenë njohuri dhe përvojë të përshtatshme profesionale në fushat e financës, auditimit, kontabilitetit, kontrollit të brendshëm ose menaxhimit të riskut.
- 5) Anëtarët e jashtëm të Komitetit përfitojnë shpërblim për pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre në veprimtarinë e Komitetit. Masa, kriteret dhe mënyra e shpërblimit përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të Shoqërisë.
- 6) Komiteti ka këto kompetenca:
 - a) monitoron efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, auditimit të brendshëm dhe menaxhimit të riskut;
 - b) shqyrton dhe vlerëson planin vjetor të auditimit të brendshëm dhe raportet e auditimit;
 - c) monitoron zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm, auditimit të jashtëm dhe organeve mbikëqyrëse;
 - d) shqyrton pasqyrat financiare dhe raportet financiare përpara paraqitjes së tyre për miratim në organet kompetente të Shoqërisë;
 - e) vlerëson integritetin dhe besueshmërinë e procesit të raportimit financiar;
 - f) mbikëqyr identifikimin, vlerësimin, monitorimin dhe administrimin e risqeve kryesore të Shoqërisë;
 - g) shqyrton politikat dhe procedurat e menaxhimit të riskut dhe propozon përmirësimet e nevojshme;
 - h) monitoron respektimin e kërkesave ligjore, rregullatore dhe të politikave të brendshme të Shoqërisë;
 - i) jep rekomandime Këshillit Mbikëqyrës për përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, auditimit dhe menaxhimit të riskut;
 - j) ushtron çdo kompetencë tjetër të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi, ky Statut, rregulloret e Shoqërisë ose e deleguar nga Këshilli Mbikëqyrës.
- 7) Komiteti mbledhet sipas nevojës, por jo më pak se katër (4) herë në vit. Mbledhjet thirren nga Kryetari i Komitetit ose me kërkesë të Këshillit Mbikëqyrës.

- 8) Komiteti mund të ftojë në mbledhjet e tij administratorët e Shoqërisë, drejtues të njësive organizative, auditues të brendshëm ose të jashtëm, si dhe ekspertë të tjerë, pa të drejtë vote, kur çmohet e nevojshme për shqyrtimin e çështjeve të caktuara.
- 9) Komiteti raporton periodikisht pranë Këshillit Mbikëqyrës për veprimtarinë e tij, konstatimet, rekomandimet dhe masat e propozuara për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të riskut.
- 10) Organizimi dhe funksionimi i hollësishëm i Komitetit rregullohen me Rregulloren e Komitetit të Auditimit dhe Menaxhimit të Riskut, e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës.

Neni 22 “Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës”

- **Pikat 5 dhe 6 riformulohen në një si vijon:** “Në funksion të vlefshmërisë së Mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës, kuorumi i nevojshëm është pjesëmarrja e më shumë se gjysmës së anëtarëve të Këshillit. Nëse nuk arrihet kuorumi, mbledhja do të shtyhet maksimumi deri në 3 (tre) ditë kalendarike”.
- **Pika 7 bëhet pika 6 ;**

Neni 24 “Procesverbalet e Këshillit Mbikëqyrës”

- **Pas pikës 1 shtohet pika 2 me përmbajtje:** “Procesverbalet e Mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës do të përmbajnë të njëjtët elementë dhe do t’u aplikohen të njëjtat rregulla, si Procesverbalet e Mbledhjeve të Asamblesë. Në çdo rast, Procesverbalet e Mbledhjes së Këshillit do të nënshkruhen nga Kryetari i mbledhjes dhe mbajtësi i procesverbalit, si dhe nga anëtarët pjesëmarrës sipas mënyrës së përcaktuar në aktet e brendshme”.

Neni 25 “Administratori”

- **Pika 2 riformulohet si vijon** “Administratori emërohet për një mandat të caktuar jo më të gjatë se 3 (tre) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje”.

Neni 27 “Kompetencat e Administratorit”

- **Në pikën 4, shkronja “g”, në fund të fjalisë të hiqet shprehja** “dhe Asamblesë së Përgjithshme”.
- **Pika 5 të riformulohet si vijon:** “Administratori mund të angazhojë këshilltarë të jashtëm, ekspertë ose shërbime mbështetëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi, buxhetin e miratuar dhe parimet e transparencës, efikasitetit dhe interesit të Shoqërisë. Administratori mbetet përgjegjës për angazhimin dhe mbikëqyrjen e tyre. Për procedurat e përzgjedhjes dhe mënyrën e funksionimit të tyre, Administratori miraton udhëzimin përkatës”.

TITULLI IV “DISPOZITA TË FUNDIT”

Neni 28 “Kontabiliteti”

- Në pikën 2 fjala “Drejtori” zëvendësohet me fjalën “Administratori”;
 - Pas pikës 3 shtohen pikat 4 deri 6, me përmbajtje si vijon:
- 4) Pasqyrat financiare vjetore i nënshtrohen auditimit ligjor të detyrueshëm nga auditues ligjor i pavarur, i emëruar nga Asambleja e Përgjithshme, i cili ushtron funksionin e tij në mënyrë të pavarur, objektive dhe pa konflikt interesi, në përputhje me legjislacionin për auditimin ligjor dhe audituesit ligjorë.;
 - 5) Shoqëria siguron që të gjitha regjistrimet kontabël dhe dokumentet financiare të jenë të aksesueshme, të gjurmueshme dhe të auditueshme në çdo kohë nga organet kompetente të kontrollit shtetëror dhe auditimit, sipas legjislacionit në fuqi;
 - 6) Ndalohet çdo ndërhyrje, ndryshim, fshehje ose manipulim i regjistrimeve kontabël. Çdo shkelje në këtë drejtim përbën shkelje të rëndë të detyrës dhe sjell përgjegjësi ligjore sipas legjislacionit në fuqi.

Tiranë me 21.08. 2026

AKSIONARI THEMELUES I VETËM

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

